

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIKE DHE SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

**VLERAT ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE, TË RËNDESISHME PËR
PËRZGJEDHJEN E FUTBOLLISTËVE PËRSPEKTIV**

Mentori:
Prof. Dr. Bylbyl Sokoli

Kandidati:
Samir Behramaj

Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË TRAJNIMIT TË USHTRIMEVE TË FORCËS EKSPLOZIVE....	7
3. QËLLIMI I PUNIMIT	9
4. HIPOTEZAT THEMELORE	10
5. METODOLOGJIA E PUNËS	11
5.1. MOSTRA E TË TESTUARVE (HULUMTUARVE).....	11
5.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	12
5.2.1. Ndryshoret antropometrike	12
5.2.2. Ndryshoret motorike bazike.....	12
5.2.3. Ndryshoret lëvizore (situacionale).....	12
5.3. KUSHTET E MATJES.....	13
5.4. MJETET MATËSE.....	14
5.5. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE ANTROPOMETRIKE.....	16
5.5.1. Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike.....	16
5.5.2. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike bazike	21
5.5.3. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike situacionale.....	24
5.6. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	27
6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE	28
6.1. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR ANTROPOMETRIK, MOTORIK BAZIK DHE MOTORIK SITUACIONAL TEK JO FUTBOLLISTËT	28
6.2. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR ANTROPOMETRIK, MOTORIK BAZIK DHE MOTORIK SITUACIONAL TEK FUTBOLLISTËT	32
6.3. MATRICA E INTERKORELACIONIT NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIK, MOTORIK BAZIKE DHE MOTORIK SITUACIONAL TE JOFUTBOLLISTËT	36
6.4. MATRICA E INTERKORELACIONIT NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIK, MOTORIK BAZIKE DHE MOTORIK SITUACIONAL TE FUTBOLLISTËT.....	40
6.5. ANALIZA REGRESIVE E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE BAZIKE SI NDRYSHORE TË PAVARURA DHE NDRYSHORËS MOTORIKE SITUACIONALE SI NDRYSHORE E VARUR TE FUTBOLLISTËT E RINJ	44
6.6. DALLIMET NË REZULTATET E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE BAZIKE DHE MOTORIKE SITUACIONALE NDËRMJET JOFUTBOLLISTËVE DHE FUTBOLLISTËVE TË RINJ	50
6.7. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	53
7. PËRFUNDIMI	54
8. LITERATURA	56
REZYME	58
SUMMARY	59

1. HYRJE

Futbolli bashkëkohor, është ndër sportet kolektive më të zhvilluara, më të shikuara dhe më të popullarizuara në botë. Është një sport, i cili kërkon përgatitje të lartë fizike dhe tekniko-taktike.

Hulumtimet e proceseve transformuese në lojën e futbollit, sidomos kur këto procese janë nën ndikimin e aktiviteteve të programuara kineziologjike, paraqesin informata bazë me qëllim të projektimit dhe kontrollit të punës, në funksion të valorizimit të mjeteve dhe detyrave për arritjen e synimeve të dëshiruara. Realizimi në nivel i detyrave të ndryshme motorike, në masë të madhe varet nga sistemi i dimensioneve antropometrike, zhvillimi dhe struktura e tyre, të cilat varësisht nga gjinia, moshja edhe ndikimi i tyre është i ndryshëm.

Definimi i konstitucionit të njeriut e sidomos i futbollistit është shumë kompleks për shkak të disa faktorëve të cilët në mënyrë direkte ndikojnë në veçoritë morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të tij. Vet reaksioni i organizmit si tërësi në disa ngacmime respektivisht sjellje në situata të ndryshme të jetes dhe punës përbëjnë grupin e të gjitha veçorive morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të cilët japin karakter konstitucionit të njeriut respektivisht paraqet fenotipin** i cili zhvillohet si simbioza e gjenotipit të caktuar i cili është nën ndikimin e faktorëve kompleks të jashtëm.

Shumë autorë dukurin apo nocionin e gjenotipit shpesh e kanë identifikuar me konstitucionin trupur. Mirëpo nocioni i konstitucionit është shumë më i gjerë dhe vet mundësia e formimit në kushte të rrethit në të cilën njeriu jeton, nën veprimin e mënyrës së të jetuarit, punës dhe edukimit na orjenton neve që të kuptojmë se në konstitucionin e njeriut ndikim fundamental kanë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të zhvillimit të njeriut.

Kur bëhet fjalë për konstitucionet nuk mundemi që ndarasi të flasemi për tipet e meshkujve dhe të femrave sepse tipet konstitucionale janë të pavarur nga gjinia, dhe se të gjitha llojet e tipeve i hasim te dy gjinit. Gjithashtu nuk ekziston ndaras ose veç konstitucioni e disa moshave sepse fëmija shumë shpejt në zhvillimin e vet ndryshon dhe më von pas vitit të 10 kemi diferencimin e parë e disa tipeve ashtu që tipin konstitucional definitiv të i rrituri do të formohet pas vitit të 20.

** Fenotipi është tërësi e të gjitha veçorive të një organizmi të cilat janë zhvilluar me veprimin e përbashkët të gjenotipit dhe kushteve të mesit në të cilin ai organizëm është zhvilluar. Nocionin e fenotipit i pari e ka përmend Johannsen në vitin 1909.

Tek njerzit e moshuar tipet konstitucionale ndryshojnë në rend të parë në drejtim komponentes funksionale. Klasifikimin e disa tipeve konstitucionale mund ta shikojmë me metodën subjektive ku dominon vëzhgimi dhe vlerësimi i disa veçoriv, te metoda tjetër është objektive ku dominon matja e disa veçorive dhe krahasimi i tyre. Më së miri është të shfrytëzohen dy metodat.

Nëse për shembull, e marrim që ta vëzhgojmë konstitucionin trupor vetëm sipas kriteriumeve morfologjike, vijmë në përfundim që ky klasifikim ka dy tipe shumë të kundërt të shprehur, ku në njëren anë mbretrojnë lartësia (parametrat e gjatësisë) dhe të tjerët gjerësia e trupit (transversale). Ekziston edhe tipi mesatar tek i cili nuk ka dominim të asnjëres nga veçoritë morfologjike të dhëna.

Antropometria, është metodë e matjes së trupit të njeriut, respektivisht të disa pjesëve të trupit, me të cilën në mënyrë kuantitative përcaktohen veçoritë morfologjike dhe shikohet pasqyra objektive e gjendjes dhe zhvillimit të njeriut.

Antropologjia morfologjike është metodë e cila përfshinë matjet e trupit të njeriut, përpunimin dhe studimin e matjeve të fituara. Në sporte të ndryshme si ato amatore ashtu edhe kulminante kjo shërben për:

- Selektionimin e kandidatve për çdo sport
- Përcjelljen dhe evoluimin e procesit stërvitor
- Vlerësimin objektiv të zhvillimit të përgjithshëm të trupit
- Kontrollimit të gjendjes së ushqyeshmërisë së sportistit
- Përcjelljen e çlodhjes së sportistit në procesin e rehabilitimit

Rëndësia e ndërtimit të trupit për sportet kulminante nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve kulminante në sportin e futbollit kulmor. Prap se prap, hulumtimet kanë treguar se futbollistët e suksesshëm tregojnë ngjajshmëri në ndërtimin dhe në raportin e masës trupore (masës yndyrore dhe joyndyrore), dhe këto shprehen më shumë duke përparuar dmth. duke arritur kategori gjithë e më të larta në sportin kulminant. Sipas kësaj, sportistët kulminant, shikuar në aspektin morfologjik janë grupë relativisht homogjene, varësisht nga sporti, është i mundur të definohet modeli i cili dëshirohet të arrihet ashtu që të arrihen rezultate kulminante.

Njohja e strukturës së disa dimensioneve të statusit psikosomatik të sportistit, me këtë edhe zhvillimit të tij, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të suksesshme të procesit stërvitor. Duke iu falënderuar numrit të madh të hulumtimeve të cilat janë marrur me përcaktimin e strukturës të disa pjesëve të

hapësirës antropometrike, në shkallën e sotme të zhvillimit të shkencës në kulture fizike, me siguri të madhe mund të flasim mbi ekzistimin e veçorive të ndryshme.

Në çdo aktivitet sportiv, pra edhe në lojën e futbollit, asnjë element teknik nuk mund të kryhet siç duhet, pa aftësitë motorike adekuate, si dhe as aftësitë motorike smund plotësisht të shprehen pa teknikë racionale gjatë lojës. Pra, është e pa imagjinueshme të flitet për zhvillimin dhe përsosjen e aftësive motorike e të mos kemi sukses në lojën e futbollit. Pra, është e pa imagjinueshme të flitet për zhvillimin dhe përsosjen e aftësive motorike ndaras nga zhvillimi, dhe përsosja e njohurive dhe shprehive motorike, te mos flasim .

Niveli i aftësive psikomotorike është parakusht i domosdoshëm për çdo lloji të lëvizjes së njeriut e për këte edhe për çdo aktivitet kineziologjik ose aktivitet sportiv sikur që është futblli. Kohëgjatësia, intensiteti dhe numri i përsëritjeve i strukturave të ndryshme lëvizore, përcaktojnë rëndësinë e disa aftësive fizike. Është e njohur thënja që sa më e ndërlikuar të jetë aktiviteti kineziologjik sipas strukturës së lëvizjes tek ajo paraqitet numër më i madh i aftësive të ndryshme motorike, kognitive, funksionale e tjera.

Disa metoda dhe mënyra të stërvitjes përsosen, vjen deri te njohjet dhe njohuritë e reja, menjanoen gabimet të cilat kanë qenë prezente dhe gjith here e më tepër tentohet të vehen në një nivel më të lartë. Kjo do të thotë se në fushën e shkencave sportive ekziston evolucioni dhe progresi dhe se në sporte aplikohen njohuritë nga shkencat tjera dhe aplikohen si të modifikuara dhe të përshtatura në sporte në përgjithësi si dhe në disa disiplina sportive. Këtu përfshihet edhe metoda pliometrike, si njëra nga metodat më të efektshme për zhvillimin e llojeve të ndryshme të forcës shpërthyes.

Në çdo sport, duke përfshirë edhe futbollin, qëllimi është për ti përmirësuar aftësitë e caktuara motorike dhe funksionale. Disa aftësi kanë rëndësi më të madhe për sukses në një sport të caktuar, ndërsa të tjerat kanë më pak. Kjo mund të shihet përmes ekuacionit të specifikimeve për një sport të veçantë. Në bazë të kësaj mund të zgjedhen metoda më shumë ose më pak të suksesshme për të përparuar në disa aftësi psikomotorik. Qëllimi është i njejtë por mënyra dhe rrugët janë të ndryshme. Qëllimi është për të gjetur një mënyrë më të shpejtë dhe më të sigurt që do të sjellë rezultate më të mira në një kohë më të shkurtër. Metoda e ushtrimeve shpërthyes është një nga metodat më efektive për përmirësimin e forces shpërthyes te sportistët, dhe për këtë arsye duhet të përfshihet në procesin e stërvitjes te çdo futbollisti, çka duhet të kemi kujdes në zgjedhjen dhe dozimin e ushtrimeve çka varet nga gjendja e sportistit, dhe gadishmërisë për të ekzekutuar nivelin e caktuar të ushtrimeve të forcës eksplozive.

E para duhet të njohemi me karakteristikat e caktuara historike lidhur me zhvillimin e metodave të ushtrimeve të forcës eksplozive, për të parë se si ajo ka përparuar gjatë gjithë historisë, dhe se si kanë ndryshuar disa qëndrime dhe kanë ardhur njohurit e reja dhe përfundimet e reja.

Pas kësaj duhet të studiohet mirë mekanizmi i veprimit të ushtrimeve eksplozive që ti kemi të njohur të gjitha proceset që ndodhin në trupin e sportistëve gjatë ekzekutimit të stërvitjes së forcës shpërthyesë, dhe gjatë kryerjes së stërvitjeve të forcës eksplozive, qëllimit të kësaj force dhe mënyrës se si arrihet ajo. Për të kuptuar këtë, duhet njohur bazat e fiziologjisë që ka të bëjë me llojet e fibrave muskulore, llojet e kontraktimeve të muskujve, etj.

Ka disa udhëzime të ushtrime të forcës eksplozive që janë baze për të kuptuar edhe më tepër zbatimin e stërvitjes së forcës eksplozive. Kjo ka të bëjë me parimin e përshtatjes, specifikat e sportit, në këtë rast të lojës së futbollit, pastaj raportit të forcës eksplozive dhe moshës, peshës trupore, nivelit të forcës, etj. Një segment shumë i rëndësishëm është zbatimi i nxemjes së drejt si dhe përgatitja e drejt e organizmit për stërvitjen e forcës eksplozive që vijon. Në kuadër të nxemjes ekzistojnë rregulla dhe detyra të caktuara të cilave duhet ti përmbahemi në mënyrë që nxemja të jetë e suksesshme.

2. HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË TRAJNIMIT TË USHTRIMEVE TË FORCËS EKSPLOZIVE

Në vendet e ndryshme të Evropës dhe ato Angloamerikane hulumtimet në fushën e lojës së futbollit janë të shumta. Ato kryesisht janë të orientuara në drejtim të gjetjes së stimulatorëve dhe operatorve më të përshtatshme kineziologjike në arritjen e rezultateve sa ma të mira në këtë sport.

Gjatë historisë shpesh është hasur në termin pliometri dhe stërvitja pliometrike si koncept i vetëm ose nën emërtime tjera, apo aspak s'është ditur për udhëheqje të tillë të trajnimit. Njerëzit ndoshta kanë vlerësuar gjithmonë forcën fizike dhe që nga kohërat e lashta, sportistët kanë kërkuar metoda për të përmirësuar shpejtësinë dhe forcën. (Bompa, 1993).

Ka dëshmi për atë se në kohën e mesme të vjetër figura qëndrore historike Teutobof thuhet se ka kërcyer pesë kuaj që ka qenë tregues i nivelit të lartë të forcës pliometrike (Bompa, 1993). Gjithashtu para 2500 viteve Grekët kanë shfrytëzuar topin të ngajshëm sikur topi medicinal në lojra të ndryshme dhe përgaditjen fizike dhe ka të ngjarë të kenë përdorur ushtrime të caktuara të hedhjes çka ishte gjithashtu ishte një lloj i trajnimit pliometrik (Bompa, 1993). Egjiptianët gjithashtu kanë përdorur topa në të njëjtën mënyrë 2000 vjet para grekëve (Bompa, 1993). Në Evropë në vitin 1470 në qytetin gjerman të Augsburg në kërcim së gjati ka fituar Princi Christoph nga Bavaria (Bompa, 1993).

Pionierët e pliometris me siguri ka të ngjarë të jenë trajnerët e atletikës në vitet e 20 - dhe 30-ta të shekullit të kaluar dhe kanë futur stërvitje të kërcimeve, si pjesë të stërvitjeve të cilat i kanë zhvilluar në palestër gjatë dimrave të gjatë në Evropën lindore dhe veriore (Bompa, 1993).

Në vitin 1933 Akademia Kombëtare Rumune për arsimin fizik ka botuar librin "Trajnimi i kërcimeve për atletët." (Bompa, 1993), ndërsa më vonë Yuri Verhoshansky në vitin 1960 ka theksuar se individët mund të përmirësojnë dukshëm aftësitë fizike të kërcimit dhe sprintit përmes stërvitjeve progresive me kërcime.

Trajnimi dhe performancat e sportistëve të tilla si Valeri Borzov, kanë ndihmuar këtë pohim (Chu, 1992). Verhoshansky eksperimentoi me përdorimin e llojeve të ndryshme të pliometris, në lidhje me përmirësimin e forcës shpërthyes. Ka argumentuar një përmirësim në tërë sistemin neuro - muskolor dhe shpejtësinë e tkurrjes (Bompa, 1993).

Në fillim të viteve të 80 - ta, studiuesit Russ Polhemus, Ed Burkhardt dhe të tjerët kanë treguar se me kombinimin e trajnimeve pliometrike dhe programit të trajnimit me peshe përmirësohet zhvillimin fizik shumë më lartë se sa arrihet me trajnim vetëm me pesha (Chu, 1992).

Në vitet e 70 – ta dhe 80 – ta shumë hulumtues, veçanarisht në Finlandë, Itali, USA dhe Gjermani në hulumtimet e tyre kanë treguar se përfitimet fiziologjike janë evidente nga trajnimi reaktive ose pliometrik (Cavagna, 1970; Komi dhe Buskirk, 1972; Bosco me bashkëpunëtor.,1976; Blattner dhe Noble, 1979; Bosco me bashkëpunëtor., 1981, 1982; Schmidtleicher dhe Gollhofer, 1982; Clutch me bashkëpunëtor, 1983; Schmidtleicher,1984; Gollhofer me bashkëpunëtor, 1987). Gjithashtu këtu hyjnë edhe autorë të tjerë të cilët botuan numër të madh të artikujve dhe libra për këtë temë (Wilt, 1978; Chu, 1983, 1984; Radcliffe dhe Farentinos, 1985;) (Bompa, 1993).

Termi pliometri është përdorur për herë të parë nga ana e Fred Wiltës, njëri nga trajnerët më të mirë amerikanë të atletikës (Chu, 1992). Ekziston informacioni për ate që supozohet se ishte sekreti i suksesit të fituesit në 100 Valery Borza 1972, i cila ka arritur të përmirësojë rezultatin prej 13,00 sek. në 10,00 sek. më trajnimin pliometrik (Chu, 1992). Studimet e para mbi zhvillimin e kontrahimeve ekscentrike - koncentrike i kan kryer Flitney dhe Hirst (1978) të muskuli i izoluar i bretkocës (Zatciorsky, 1995), ndërkohë që efektin pozitiv të veprimit të zgjatjes së mëparshme të karakteristikat kontrahuese të muskujve në situata motorike kanë vërtetuar Bonde Petersen (1974), Cavagna (1974) dhe Verkoshansky (1977). (Bompa, 1993). Disa autorë theksojnë se rusët kanë shpikur pliometrinë, por kjo është e gabuar, sepse çdo fëmijë i cili kërcen mbi litar ose duke luajtur "lojë fëmijësh me kërcime" është në fakt pliometri. Gjithashtu cili do kërcim nga gjimnastika ka të bëjë me pliometrinë, dhe nga kjo pikë historike referimi kemi treguar për ekzistencën e pliometrise dhe trajnimit pliometrik. Gjitha kërcimet si elemente teknike në lojën e futbollit i përkasin pliometrisë.

Njeriu gjatë çdo ecje dhe vrapimi, dhe çdo formë të kërcimeve ose duke e shtyrë dhe hedhur, përdor kontrahimin pliometrik dhe në këtë mënyrë një lloj të veçantë të trajnimit pliometrik.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Numri i paktë dhe i kufizuar i hulumtimeve sa i përket aplikimit dhe ndikimit të ushtrimeve pliometrike në përgatitjen kondicionale të futbollistët kërkon, që kësaj problematike të përgatitjes kondicionale ti qasemi me perkushtim të madh. Niveli i ulët i efekteve reale të arritura të këtij procesi në praktikën tonë, kërkon në mënyrë imperative që përpos masave dhe zgjidhjeve në këtë fushë të antropologjisë, të vijë deri tek informacionet e duhura relevante shkencore të cilat do të plotësojnë njohurit teorike, dhe ti sigurojnë pjesës praktike mbështetje të sigurt për punë të suksesshme.

Qëllimi kryesor i punimit është që të përshkruhet dhe të vërtetohet ndikimi i tretmaneve kineziologjike ose ndikimi i tretmane stervitore të futbollistët dhe të vërtetohet dallimi në mes jofutbollistëve dhe fitbollistëve të rinj nën ndikimin e këtyre seancave stervitore.

Objektivi primar i këtij punimi mbështetet në vlerimin e vlerave antropometrike dhe motorike, të rëndësishme për perzgjedhjen e futbollistëve perspektiv dhe konsiston në :

- Vërtetimin e relacioneve në mes hapësirës morfologjike dhe asaj lëvizore të dy grupet e të testuarve.
- Vërtetimin e relacioneve në mes hapësirës lëvizore bazike dhe asaj situacionale motorike.
- Vërtetimi i ndikimit të variablave antropometrike dhe motorike, në ekzekutimin e elementit situacional.
- Vërtetimin e dallimit në mes grupit të jofutbollistëve dhe futbollistëve në ndryshoret antropometrike, motorike bazike dhe situacionale motorike

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Me qëllim të vërtetimit të saktë kërkimor të qëllimit të hulumtimit dhe objektivave primare, janë parashtruar hipotezat themelore si:

- **H1:-** Do të fitohen relacione të rëndësishme në mes hapësirave antropometrike, motorike bazike dhe motorike situacionale.
- **H2:-** Variablat antropometrike dhe motoriko-bazike, do të kenë ndikim të rëndësishëm statistikor në ekzekutimin e elementeve situacionale në futboll.
- **H3:-** Do të fitohen ndryshime të rëndësishme në mes mostrës së futbollistëve dhe jofutbollistëve të rinj, në karakteristikat antropometrike, motorike-bazike, dhe situacionale motorike.

5. METODOLOGJIA E PUNËS

5.1. MOSTRA E TË TESTUARVE (HULUMTUARVE)

Në këtë punim janë testuar 60 nxënës të klasëve të gjashta, mosha 12 vjeç \pm 6 muaj të shkollës fillore të gjinisë mashkullore, dhe 60 nxënës të po së njejtës moshë të cilët ndjekin ushtrimet e rregullta në shkollën e futbollit. Pasi qe nxënësit rregullisht vijojnë procesin mësimorë, dhe realizojnë detyrat e parapara me programin e edukatës fizike, atëherë është e natyrshme se të gjithë janë të aftë ne aspektin psikofizik që t'i nënshtrohen testimit. Përherë duhet pasur parasyshë që më rastin e testimit, nxënësit të jenë në gjëndje të mirë shëndetësore, si dhe rënditja e realizimit të testeve të bëhet në mënyrë që në pasditën e parë të bëhen matjet antropometrike, në të dytën të bëhen testet lëvizore bazike, dhe në pasditën e tretë, të bëhen testet lëvizore situacionale.

5.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE

5.2.1. Ndryshoret antropometrike

Për hulumtimin e hapësirës antropometrike do të përfshihën këto ndryshore:

- ALARTR- lartësia e trupit,
- AGJKËM- gjatësia e këmbës,
- APESHA- pesha trupore,
- APERKO-perimetri i kofshës,
- APERKC-perimetri i kërcirit.

5.2.2. Ndryshoret motorike bazike

Për hulumtimin e hapësirës motorike bazike do të përfshihën këto ndryshore:

- MKVGJAT- kërcim nga vendi në gjatësi,
- MKVLART- kërcim nga vendi në lartësi.
- MVR20m- vrapim 20 metra.

5.2.3. Ndryshoret lëvizore (situacionale)

Për hulumtimin e hapësirës motorike situacionale do të përfshihën këto ndryshore:

- MUTD3x10m- Udhëheqja e topit drejt 3x10m, testusi udhëheq topin 10m e para,dorzon topin ne cak,kthehet vrapim mbrapa merr topin tjetër,e perserit 3-herë
- MUTSD5P- Udhëheqja e topit sllallom drejt 5 pengesa,distance mes tyre 1.5m,vajtje-ardhje.
- MUTSZZ5P- Udhëheqja e topit sllallom zig-zag 5 pengesa,te vendosura ne kandin 45 shkall,distance mes tyre 1.5m,vajtje-ardhje.

5.3. KUSHTET E MATJES

1. Matjet antropometrike janë ekzekutuar në orët e para të pasdites.
2. Instrumentet matëse kanë qenë të punimit standard dhe kanë qenë të bazhduara së paku çdo ditë para matjeve.
3. Vendi ku janë ekzekutuar matjet ka qenë hapësira e mjaftueshme dhe e ndriçuar mirë, ndërsa temperatura e ajrit rreth 22°.
4. Në vendin ku janë ekzekutuar matjet (sallë e edukatës fizike) kanë qenë pesë matës, shkruesi i rezultateve dhe grupi prej pesë të testuarve (secili matës nga një të testuar të cilët janë zëvendësuar pas matjes).
5. Të testuarit para matjes kanë qenë zbathur dhe vetëm në brekë.
6. Në çdo të testuar, para matjes, janë përcaktuar dhe shënuar në mënyrë të saktë nivelet dhe pikat antropometrike të cilat kanë qenë në programin e matjeve.
7. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë i ka matur i njëjti matës. Rezultatet e matjes janë lexuar gjatë kohës deri sa testuesi ka matur, ndërsa personi cili i ka shkruar rezultatet, për ti kontrolluar i ka përsëritur rezultatet me zë të çartë.
8. Matjet e ekstremiteteve çift të trupit janë ekzekutuar në anën e majtë të trupit.
9. Matjet antropometrike janë përsëritu nga tri herë.

5.4. MJETET MATËSE

Për aplikimin e këtij programi të matjeve janë shfrytëzuar këto instrumente antropometrike dhe kjo teknikë e matjes:

1. Peshorja (transportabile) e cila mundëson matjen me saktësi prej 0,5 kg dhe tek e cila ekziston mundësia e rregullimit të akrepave në pozitë zero. Peshorja bazhdohet çdo ditë para përdorimit dhe pas çdo dhjet matjeve.




2. Antropometri sipas Martinit (në të cilën janë të shënuar centimetrat dhe milimetrat).



- 3 Traka matese prej materiali të plastikës me gjatësi prej 150 cm të shënuara milimetrat)



4. Kronometri për matjen e kohës së ekzekutimit të testit



4. Konat plastike për ekzekutimin e testeve situacionale motorike (udhëheqjen e topit)



4. Topi i futbollit



5.5. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE ANTROPOMETRIKE

5.5.1. Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

1. Lartësia e trupit (ALARTR) – matet me antropometer, entiteti që matet duhet të jetë i zbathur në brekë sportive të qëndroj në bazë të fortë horizontale. Koka e tij duhet të jetë në pozitë ku duhet rrespektuar horizontalja e frankfurtit. Qendrimi i trupit te entitetit duhet te jeti i relaksuar dhe i drejt , nderkaq matesi qendron ne anen e majt te entitetit. pasi qe e kontrollon poziten e entitetit dhe te instrumentrit (antropometrit), e leshon krahum horizontal te antropometrit deri ne pjesen parietale te kokes (pika me e lart e kokes – vertex). Rezultati lexohet me saktesi 0.1 cm.

Foto 1. Lartësia e trupit



2. Gjatësia e këmbës (AGJKËM) – i eksperimentuari duhet të qendroj sikurse në matjen e lartesis së trupit, matje është kryer me shirit centimetrik nga dyshemeja ku qendron entiteti deri te pika e quajtur “gjemb i siperm i perparm i çopokut” në anën e majtë të këmbës. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto2. Gjatësia e këmbës



3. Pesha e trupit (APESHA) – matet me peshore decimale me saktësi deri në 0.1kg. Peshorja vendoset në sipërfaqe të rrafshet. I testuari vendoset në mes të peshorës duke marrë pozicionin e drejtë. Gjatë matjes i testuari mbanë të veshur veshje sportive (vetëm në brekë) dhe pas se ciles matje peshorja kthehet ne zero (0)

Foto 3. Pesha e trupit



4. APERKO– Perimetri i kofshës është matur me shirit milimetrik. I maturi qëndron në këmbë me gjymtyrë të poshtme diç të larguara. Shiriti vendoset në të tretën e sipërme të kofshës (gjerësia më e madhe). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto 4. Perimetri i kofshës (APERKO)



5. Perimetri i nëngjurit në drejtqëndrim – kërcirit (APERKC) –(në drejtqëndrim) është matë me trakën matëse gjysmë plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim. Traka matëse mbështjellët rreth pjesës së nëngjurit të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet zogut të këmbës dhe pjesës së eperme të tibies. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

5. Perimetri i nëngjurit (kercirit)në drejtqëndrim)



5.5.2. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike bazike

6. Kërcim së gjati nga vendi në gjatësi – MKVGJAT

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtëqëndrimi me këmbë të thyera në gjuhë që mundëson kërcim më të sukseshëm.

Realizimi i detyrës: I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Foto 6. Kërcim së gjati nga vendi (MKRGJV)



7. Kërcim nga vendi në lartësi – MKVLART

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjërësi të legenit.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu epen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. I testuari bënë disa tentime provuese.

Foto 7. Kërcim nga vendi në lartësi



8. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20M

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 20m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 8. Vrapimi 20 metra nga starti i lartë (MV20ML)



5.5.3. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike situacionale

9. Udheheqja e topit drejt 3x10m (MUTD3X10M)

Instrumentet: Përdoren 2 kona në 2 pika në një largësi në mes veti prej 1000cm në një vij të drejt dhe topi i futbollit.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për udhëheqje të topit në vij të drejt në distancë prej 10 metrave.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “tash” nga matësi, dhe sinjalit të dhënë i testuari fillon udhëheqja e topit drejt 3x10m, testusi udhëheq topin 10m e para, dorzon topin ne cak, kthehet vrapim mbrapa merr topin tjetër, e perserit 3-here

Vlerësimi: Matet shpejtësia e kalimit ose udhëheqjes së topit e cila vlerësohet e kalimin e kohes prej startit deri në perfundimin dhe kthimi ne piken e startit neper kona te vendosur në menyre zig-zage në të dhjetat e sekondes.

Udhëzime të testuarit: te testuarit i bëjnë nga disa udhëheqjes provuese të topit para se të fillojnë testimin.

Foto 9. Udheheqja e topit drejt 3x10m



10. Udhëheqja e topit sllallom drejt 5 pengesa, distanca mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje (MUTSD5P)

Instrumentet: Përdoren 6 kona në 6 pika në një largësi në mes veti prej 150cm në një vij të drejt dhe topi i futbollit.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për udhëheqje të topit drejt në distancë prej 750 +750 centimetrave.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “tash” nga matësi, dhe sinjalit të dhënë i testuari fillon udhëheqja e topit sllallom drejt 5 pengesa, distance mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje.

Vlerësimi: Matet shpejtësia e kalimit ose udhëheqjes së topit e cila vlerësohet ne kalimin e kohes prej startit deri në perfundimin dhe kthimi ne piken e startit neper kona te vendosur në menyre te drejte në të dhjetat e sekondes.

Udhëzime të testuarit: te testuarit i bëjnë nga disa udhëheqje provuese të topit para se të fillojnë testimin.

Foto 10. Udhëheqja e topit drejt 5 pengesa, distance mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje



11. Udhëheqja e topit sllallom zig-zag 5 pengesa, distanca mes tyre 1.5m, te vendosura ne kandin 45 shkall, vajtje-ardhje (MUTSZZ5P)

Instrumentet: Përdoren 6 kona në 6 pika në një largësi në mes veti prej 150cm te vendosura në kandin 45 shkall dhe topi i futbollit.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për udhëheqje të topit zig zag të drejt në distancë prej 750 +750 centimetrave.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “tash” nga matësi, dhe sinjalit të dhënë i testuari fillon udhëheqja e topit sllallom zig-zag 5 pengesa, te vendosura ne kandin 45 shkall,distance mes tyre 1.5m,vajtje-ardhje.

Vlerësimi: Matet shpejtësia e kalimit ose udhëheqjes së topit e cila vlerësohet ne kalimin e kohes prej startit deri në perfundimin dhe kthimi ne piken e startit neper kona te vendosur në menyre zig-zage në të dhjetat e sekondes.

Udhëzime të testuarit: te testuarit i bëjnë nga disa udhëheqje provuese të topit para se të fillojnë testimin.

Foto 11. Udhëheqja e topit drejt 5 pengesa zig-zag, te vendosura ne kandin 45 shkall distance mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje



5.6. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Për të dy grupet e sistemit të variablove (dy ekipet finaliste) do të llogariten parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilin element, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

Vlerat minimale dhe maksimale (R.min-R.maks)

Mesatarja aritmetikore (Ma)

Devijimi standard(Ds)

Parametrat e asimetrisë (SKEW dhe KURT)

Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet elementeve teknike në futboll, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablove.

Për vërtetimin e ndryshimeve ndërmjet dy ekipeve në parametrat antropometrik, motorike bazik dhe motorike situacionale, do të aplikohet analiza discriminative e **T – testit**.

Për të vërtetuar lidhmërinë dhe ndikimin në mes variablove prediktore (të pavarura) dhe asaj kriterike (së varur) do të aplikohet **analiza regressive** në hapësirën manifeste.

6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE

6.1. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR ANTROPOMETRIK, MOTORIK BAZIK DHE MOTORIK SITUACIONAL TEK JO FUTBOLLISTËT

Në tabelën 1 është paraqitur analiza deskriptive e parametrave themelor statistikor të ndryshoreve antropometrik, motorik bazik dhe motorik situacional te jofutbollistët e moshës 12 vjeçare ± 6 muaj. Mostra ka përfshirë grupin 60 jofutbollist të gjinisë mashkullore të moshës 12 vjeçare ± 6 muaj ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikoneve të paraqitura nën tabelë.

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike, motorike bazike dhe motorike situacionale, te jofutbollistët e moshës 12 vjeçare ± 6 muaj

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTR	60	129.00	156.00	142.6833	6.62172	-.043	-.473
AGJKËM	60	80.00	97.00	87.4000	4.50311	.073	-.699
APESHA	60	24.00	58.00	34.5000	7.26613	1.654	3.159
APERKO	60	31.00	53.00	38.2000	5.11495	1.199	1.641
APERKC	60	22.00	37.00	28.0167	2.83735	1.401	3.377
MKVGJAT	60	105.00	176.00	132.8333	15.26508	.325	-.194
MKVLART	60	19.00	44.00	30.0000	6.34329	-.087	-.642
MVR20M	60	3.70	6.70	4.4078	.52766	2.153	7.142
MUTD3x10m	60	17.00	25.00	20.2833	1.86030	.436	.057
MUTSD5P	60	9.00	21.00	14.0950	2.96450	.699	.095
MUTSZZ5p	60	10.00	37.00	18.0167	4.35887	1.745	5.426

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, lartësia e trupit (ALARTR) është 142.68cm. Rezultati minimal (129.00 cm) dhe ai maksimal (156.00 cm) i ndryshorës lartësia e trupit tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri jo të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, gjatësia e këmbës (AGJKËM) është 87.40 cm. Rezultati minimal (80.00 cm) dhe ai maksimal (97.00cm) i ndryshorës gjatësia e këmbës tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë ndryshore antropometrike. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, pesha e trupit (APESHA) është 34.50kg. Rezultati minimal (24.00 kg.) dhe ai maksimal (58.00 cm) i ndryshorës pesha e trupit tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Ekzistimi i një dallimi të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike të volumenit trupor perimetri i kofshës (APERKO) është 38.20cm. Rezultati minimal (31.00kg) dhe ai maksimal (53.00gk) i ndryshorës perimetri i kofshës tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë ndryshore antropometrike. Ekzistimi i një dallimi të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike të volumenit trupor perimetri i kërcirit (APERKC) është 28.01 cm. Rezultati minimal (22.00 cm) dhe ai maksimal (37.00 cm) i ndryshorës perimetri i kërcirit tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë ndryshore antropometrike. Ekzistimi i një dallimi të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e variablës kërcim së gjati nga vendi (MKVGJAT) është 132.83 cm. Rezultati minimal (105.00 cm) dhe ai maksimal (176.00 cm) i testit kërcim së gjati nga vendi tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë test motorik bazik, si dhe një anim të lehtë

të testeve ka rezultate të larta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e variablës kërcim së gjati nga vendi (MKVLART) është 30.00cm. Rezultati minimal (19.00 cm) dhe ai maksimal (67.00 cm) i testit kërcim së gjati nga vendi tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë test motorik bazik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate të larta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës vrapim në 20 metra nga starti i lartë (MVR20M) është 4.40 sek. Rezultati minimal (3.70 sek) dhe ai maksimal (6.70 sek) i testit vrapim në 20 metra nga starti i lartë tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë test motorik-specifik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Ekzistimi i një dallimi të theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës udhëheqje e topit 3x10 metra (MUTD3x10) është 20.28 sek. Rezultati minimal 17.00 sek) dhe ai maksimal (25.00 sek) i testit udhëheqje e topit në 3x10 metra tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë test motorik bazik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri jo të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës udhëheqja e topit sllallom drejt 5 pengesa, distance mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje (**MUTSD5P**) është 14.09sek. Rezultati minimal (9.00sek) dhe ai maksimal (21.00sek) i testit udhëheqja e topit sllallom drejt 5 pengesa, distance mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje, tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë test motorik-specifik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Në këtë testë teknik apo motorik situacional nuk ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, nga kjo shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri jo të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës teknika, udhëheqja e topit sllallom zig-zag 5 pengesa, te vendosura ne kandin 45 shkall,distanca mes tyre 1.5m,vajtje-ardhje (MUTSZZ5p) është18.01sek. Rezultati minimal (10.00sek) dhe ai maksimal (37.00sek) i testit udhëheqja e topit sllallom zig-zag 5 pengesa, te vendosura ne kandin 45 shkall,distanca mes tyre 1.5m,vajtje-ardhje tregon për një dallim të theksuar në mes jofutbollistëve në këtë test motorik situacional, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Në këtë testë teknik apo motorik situacional ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, nga kjo shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri të theksuar.

6.2. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR ANTROPOMETRIK, MOTORIK BAZIK DHE MOTORIK SITUACIONAL TEK FUTBOLLISTËT

Në tabelën 2 është paraqitur analiza deskriptive e parametrave themelor statistikor të ndryshoreve antropometrik, motorik bazik dhe motorik situacional te futbollistët e moshës 12 vjeçare ± 6 muaj. Mostra ka përfshirë grupin 60 futbollistë të gjinisë mashkullore të moshës 12 vjeçare ± 6 muaj ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikoneve të paraqitura nën tabelë.

Tabela 2. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike, motorike bazike dhe motorike situacionale, te futbollistët e moshës 12 vjeçare ± 6 muaj

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTR	60	136.00	169.00	149.7000	8.22007	.217	-.185
AGJKËM	60	62.00	98.00	85.6500	7.47158	-1.003	1.920
APESHA	60	27.00	59.00	38.4667	8.06009	.870	-.126
APERKO	60	32.00	51.00	40.6833	4.41681	.435	-.496
APERKC	60	25.00	36.00	29.2333	2.67675	.778	.117
MKVGJAT	60	122.00	200.00	152.3500	16.66807	.158	-.126
MKVLART	60	23.00	49.00	31.4667	5.61918	1.028	.980
MVR20M	60	3.13	4.48	3.7047	.29658	.521	.473
MUTD3x10m	60	16.00	20.00	17.6333	1.22082	.286	-.967
MUTSD5P	60	7.00	12.00	8.8167	1.12734	1.476	2.072
MUTSZZ5p	60	12.00	18.00	14.1167	1.39115	.918	.708

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, lartësia e trupit (ALARTR) është 149.70cm. Rezultati minimal (136.00 cm) dhe ai maksimal (168.00 cm) i ndryshorës lartësia e trupit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri jo të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, gjatësia e këmbës (AGJKËM) është 85.65cm. Rezultati minimal (62.00 cm) dhe ai maksimal (98.00cm) i ndryshorës gjatësia e këmbës tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrike. Ekzistimi i një dallim të theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores, pesha e trupit (APESHA) është 38.46kg. Rezultati minimal (27.00 kg.) dhe ai maksimal (59.00kg) i ndryshorës pesha e trupit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik. Edhe pse ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, rezultetet tregojn se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike të volumenit trupor perimetri i kofshës (APERKO) është 40.68cm. Rezultati minimal (32.00 cm) dhe ai maksimal (51.00cm) i ndryshorës perimetri i kofshës tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrike. Edhe pse ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, rezultetet tregojn se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike të volumenit trupor perimetri i kërcirit (APERKC) është 29.23 cm. Rezultati minimal (25.00 cm) dhe ai maksimal (36.00 cm) i ndryshorës perimetri i kërcirit tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore antropometrike. Edhe pse ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, rezultetet tregojn se lakueshmëria dhe konveksiteti i distribucionit të fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e variablës kërcim së gjati nga vendi (MKVGJAT) është 152.35 cm. Rezultati minimal (122.00 cm) dhe ai maksimal 200.00 cm) i testit, kërcim së gjati nga vendi tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë test motorik bazik, si dhe një anim të lehtë të

testeve ka rezultate të larta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e variablës kërcim së gjati nga vendi (MKVLART) është 31.00cm. Rezultati minimal (23.00 cm) dhe ai maksimal (49.00 cm) i testit kërcim së gjati nga vendi tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë test motorik bazik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate të larta. Ekzistimi i një dallim të theksuar në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) kanë një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës vrapim në 20 metra nga starti i lartë (MVR20M) është 3.70 sek. Rezultati minimal (3.31 sek) dhe ai maksimal (4.48 sek) i testit vrapim në 20 metra nga starti i lartë tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë test motorik-specifik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës udhëheqja e topit 3x10 metra (MUTD3x10) është 17.63 sek. Rezultati minimal (16.00 sek) dhe ai maksimal (20.00 sek) i testit udhëheqje e topit në 3x10 metra nga tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë test motorik bazik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri jo të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës udhëheqja e topit sllallom drejt 5 pengesa, distanca mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje (MUTSD5P) është 8.81 sek. Rezultati minimal (7.00sek) dhe ai maksimal (12.00sek) i testit udhëheqja e topit sllallom drejt 5 pengesa, distanca mes tyre 1.5m, vajtje-ardhje, tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë test motorik-specifik, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Në këtë testë teknik apo motorik situacional nuk ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, nga kjo shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri jo të theksuar.

Mesatarja aritmetikore e ndryshorës teknika udhëheqja e topit sllallom zig-zag 5 pengesa, te vendosura ne kandin 45 shkall,distanca mes tyre 1.5m,vajtje-ardhje (MUTSZZ5p) është14.11sek. Rezultati minimal (12.00sek) dhe ai maksimal (18.00sek) i testit udhëheqja e topit sllallom zig-zag 5 pengesa, te vendosura ne kandin 45 shkall,distanca mes tyre 1.5m,vajtje-ardhje tregon për një dallim të theksuar në mes futbollistëve në këtë test motorik situacional, si dhe një anim të lehtë të testeve ka rezultate te larta. Në këtë testë teknik apo motorik situacional ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, nga kjo shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri jo të theksuar.

6.3. MATRICA E INTERKORELACIONIT NDËRMJET NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE, MOTORIKE BAZIKE DHE MOTORIKE SITUACIONALE TE JOFUTBOLLISTËT

Në tekstin në vazhdim do të paraqiten dhe analizohen koeficientet e korrelacionit të thjesht linear të variablave antropometrike dhe motorike bazike dhe motorike situacionale te jo futbollistët. Për shkak të pasqyrimin më të mirë të tabelës dhe për të vërejtur më qartë korrelacionet e rëndësishme të niveleve të ndryshme të lidhmëris, koeficientet në fjalë janë evidentuar me shenjen e yllit.

